



## Departamenti i Prokurimit

Prishtine: datë, 21.01.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 22.07.2022 të parashtruar nga Operatori Ekonomik Grupi i OE "BESIONI" lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i rrugeve në Shkabaj Alush Hoti dhe Hazir Haxholli", me Nr. të Prok: 616-22-4689-5-2-1 dhe numër të brendshëm 616 22 047 521 nxjerr:

### V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "BESIONI" të dt. 22.07.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i rrugeve në Shkabaj Alush Hoti dhe Hazir Haxholli" me 616-22-4689-5-2-1 Nr. Brendshëm 616 22 047 521, kundër Vendimit të Njoftimit të AK së, të datës 19/07/2022 të publikuar në web-faqe të KRPP-së=
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

AK duke u mbështetur në LPP dhe në RRUP i gjatë vlerësimit të ofertave ka konstatuar se ju nuk keni plotësuar kërkesat teknike dhe profesionale. Në kërkesat teknike dhe profesionale ka qenë e kërkuar që:

**2.OE-ik duhet të ofroj dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon;**

- Menaxheri i projektit inxh. i ndërtimit (drejtimi konstruktiv) - 5 vite përvojë pune pas diplomimit,

- Një Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv ose infrastrukture rrugore- 3 vite përvojë pune pas diplomimit,

Ju në ofertën tuaj keni dorëzuar dy inxhinier të ndërtimit siq janë:

1. Haxhi Krasniqi Konstruktiv dhe
2. Leke Krasniqi Konstruktiv

# DIPLOMË

E STUDIMEVE PASDIPLOMIKE - MASTER

**LEKË (BAJRAM) KRASNIQI**

I LINDUR MË 17.05.1983 NË PRISHTINË KOMUNA PRISHTINË  
ËSHTË REGJISTRUAR NË VITIN AKADEMIK 2006/2007  
ËSHTË TRANSFERUAR NË UBT NË VITIN AKADEMIK 2017/2018

MË 28.10.2019 MBROJTI TEZËN E PUNIMIT MASTER ME TEMË  
"KONTROLLI I KONFORMITETIT TË BETONIT SIPAS SK EN 206:2013  
GJATË NDËRTIMIT TË URËS B400 NË AUTOSTRADËN "ARBËN XHAFERI"

NË PROGRAMIN: INXHINIERI NDËRTIMORE  
(NDËRTIMTARI) DHE INFRASTRUKTURË  
ME SPECIALIZIM NË: INXHINIERI STRUKTURORË

DHE FITOI GRADËN:

MASTER I SHKENCAVE  
NË INXHINIERI NDËRTIMORE  
(NDËRTIMTARI) DHE INFRASTRUKTURË  
ME SPECIALIZIM NË: INXHINIERI STRUKTURORË

NIVELI 7 - KKK/KEK

Nota mesatare gjatë studimeve: 9.21  
Gjithsej 120 ECTS

# DIPLOMË

E STUDIMEVE PASDIPLOMIKE - MASTER

**LEKË (BAJRAM) KRASNIQI**

I LINDUR MË 17.05.1983 NË PRISHTINË KOMUNA PRISHTINË  
ËSHTË REGJISTRUAR NË VITIN AKADEMIK 2019/2020  
MË 24.06.2021 MBROJTI TEZËN E PUNIMIT MASTER ME TEMË

"AUDITIMI I ELEMENTEVE TË SIGURISË RRUGORE  
NË AUTOSTRADËN "ARBËN XHAFERI"

NË PROGRAMIN: INXHINIERI NDËRTIMORE  
(NDËRTIMTARI) DHE INFRASTRUKTURË  
ME SPECIALIZIM NË: INFRASTRUKTURË RRUGORE

DHE FITOI GRADËN:

MASTER I SHKENCAVE  
NË INXHINIERI NDËRTIMORE  
(NDËRTIMTARI) DHE INFRASTRUKTURË  
ME SPECIALIZIM NË: INFRASTRUKTURË RRUGORE

NIVELI 7 - KKK/KEK

Nota mesatare gjatë studimeve: 9.68  
Gjithsej 120 ECTS

*TE dy këto diploma tregojnë se inxhinieri i ndërtimit konstruktiv Leke Krasniqi nuk ka përvojë pune 5 vite pas diplomimit e as 3 vite pas diplomimit. Njëra diplome tregon se ju keni mbrojtur tezen e masterit me dt. 28.10. 2019 , ndërsa tjetra me 24.06.2021.*

*Ne kërkesat e kërkuara ne Njoftimin per kontrate dhe ne Dosjen e Tenderit shihet qarte se është kërkuar inxhinier i ndërtimit konstruktiv (qe nënkupton inxhinier i ndërtimit 5 vjeçar apo inxhinier i ndërtimit bachelor + master), ndërsa ne inxhinieret tjerë shihet qarte se është kërkuar inxhinier apo bachelor te lemive te caktuara.*

AK – komisioni i vleresimit, ka bere vleresimin e ofertave gjithnje duke u mbeshtetur ne LPP dhe ne Rregullat e Udhezuesit Operativ per prokurim Publik.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më larte ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij Vendimi.

  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

